




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. 20/DPK	Nr. Prot. Br. Prot. 01-3048/14
Nr. l faq. Broj stranica 02	Data Datum 01-09-2014
Nr. pages	Date
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	29.08.2014
REFERENC-Ë:	AKK- DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Fatmir GJONBALAJ Drejtor i Njesisë së Prokurimit- Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh.a.
CC:	z. Ejup QERIMI Kryeshf Ekzekutiv – Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh.a.
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull " Furnizim me telefona mobil (smartphones) për lojë shpërblyese "



I nderuari, z. GJONBALAJ,

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin " Furnizim me telefona mobil smartphones për lojë shpërblyese " me nr. të prokurimit: PTK-14-082-121, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Në lidhje me tenderin me titull " Furnizim me telefona mobil smartphones për lojë shpërblyese " me nr. të prokurimit: PTK-14-082-121, i iniciuar nga Autoriteti kontraktues Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës .

A r s y e t i m

Njësia e Prokurimit pranë Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës sh.a ka përgatitë njoftimin për kontratë me titull *“Furnizim me telefona mobil (smartphones) për lojë shpërblyese” me nr. të prokurimit: PTK-14-082-121*, e cila është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me datë 23.04.2014, në Procedurë të Hapur. Agjencia kundër Korrupsionit sipas detyrës zyrtare ka kërkuar tërë dokumentacionin lidhur me këtë procedurë të prokurimit dhe pas ekzaminimit dhe krahasimit të dokumentacionit në dispozicion ka konstatuar të dhënat si në vijim:

Në njoftimin për kontratë i cili është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së, Autoriteti kontraktues ka kërkuar që të furnizohet me telefona mobil për lojën shpërblyese të cilën e ka organizuar për klientët e saj. Tek pjesa II. Sasia apo fushëveprimi i kontratës e njoftimit për kontratë është përmendur emri i prodhuesit të telefonave dhe i është shtuar fjala ekuivalent. Pas kësaj, Agjencia ka ftuar ne takim zyrtarin përgjegjës të prokurimit të Autoritetit kontraktues ku është kërkuar të sqarohet kjo kërkesë e vendosur nga ana e Autoritetit kontraktues. Zyrtari përgjegjës i prokurimit ka theksuar se arsyeja se pse është përmendur emri i prodhuesit qëndron në faktin se edhe klientët e dëshirojnë një markë të tillë të telefonave dhe se për këtë kemi edhe raportin analitik i cili është bërë nga Departamenti i Marketingut pranë PTK-së, ku del se një përqindje e madhe e klientëve i dëshirojnë telefonat të markave si *Samsung, Iphone ose HTC* dhe për dallim prej prodhueseve të tjerë ky prodhues ka çmimet më të lira.

Agjencia kundër Korrupsionit me dt.16.05.2014 ka paraqitur kërkesë tek Autoriteti kontraktues që ta ofrojë të gjithë dokumentacionin pasi të përfundon procesi i vlerësimit të tenderëve.

Pas trajtimit të dokumentacionit për këtë procedurë të prokurimit, Agjencia ka konstatuar se dosjen e tenderit e kanë tërhequr 17 OE ndërsa vetëm 6 prej tyre i kanë dorëzuar ofertat e tyre për këtë tender.

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit të tenderëve i përgatitur nga ana e Komisionit vlerësues, OE i cili është propozuar për dhënie të kontratës i plotëson të gjitha kërkesat e vendosur në dosjen e tenderit si dhe prej Operatorëve të përgjegjshëm ka ofruar çmimin më të ulët. Agjencia kundër Korrupsionit pasi ka shqyrtuar dhe ekzaminuar me kujdes dokumentacionin e ofruar lidhur me këtë procedurë të prokurimit, dhe pas takimit zyrtar që ka realizuar me zyrtarin përgjegjës të prokurimit të Autoritetit kontraktues i cili ka sqaruar kërkesën e vendosur, Agjencia nuk ka gjetur prova të mjaftueshme me të cilat do të evidentohet ndonjë shkelje e dispozitave të LPP-së.

Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Me respekt !